

Zabeli, Leart

KUVENDI KOMUNAL
MUNICIPAL ASSEMBLY
01 Nr. 031-3938
Më 06.06.2008
On GLLOGOC



Në bazë të nenit 5.1 dhe 5.3 të Rregullores nr. 2007/30 mbi ndryshimin e Rregullores 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, neni 34.2 germa (e) të Statutit të Komunës së Gllogocit, Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e vetë të mbajtur me 29.05.2008 aprovoi këtë:

R R E G U L L O R E
MBI ORGANIZIMIN E BASHKËSIVE, FSHATRAVE, VENDBANIMEVE DHE
LAGJEVE URBANE, KOMPETENCAT DHE RREGULLAT E PROCEDURËS
PËR BASHKËPUNIM NË MES TË KOMUNËS DHE FSHATRAVE E
BASHKËSIVE

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1.

Me këtë Rregullore do të përcaktohet:

- Organizimi i bashkësive, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
- Format e bashkëpunimit në mes të komunës, bashkësive, fshatrave dhe lagjeve urbane.
- Vëllimi i punëve që do të ushtrojë bashkësitë dhe fshatrat në kuadër të kompetencave të tyre.
- Ushtrimi i punëve dhe aktiviteteve që janë në përgjegjësinë dhe kompetencat e komunës por që me pëlqimin e komunës dhe në marrëveshje me fshatrat dhe bashkësitë do ti ushtrojnë këto të fundit

Organizimi i bashkësive dhe fshatrave

Neni 2.

Organizimi i bashkësive dhe fshatrave është organizimi apolitik.
Zgjedhja e anëtarëve të Komitetit të bashkësisë dhe fshatit behet drejtë për drejtë nga qytetaret që përfaqësojnë të gjitha interesat e qytetarëve jashtë bazave partiake.

Neni 3.

Bashkësia e fshatrave është bashkësi e dy apo më shumë fshatra përkatësisht vendbanimeve apo lagjeve urbane me qëllim të realizimit dhe përmbushjes së interesave e nevojave të përbashkëta për fshatrat e bashkësisë.

Neni 4.

Fshati është njësi e parë organizative e qytetarëve të një vendbanimi apo dy e më shumë lagjeve dhe vendbanimeve në të cilin qytetarët në mënyrë të drejtë për drejtë i realizojnë interesat e tyre individuale dhe të përbashkët në sferat e caktuara të jetës dhe të punës.

Neni 5.

Territori i Komunës së Glllogocit në aspektin administrativ dhe politik është organizuar në bashkësi sipas nenit 10 të Statutit të Komunës së Glllogocit të aprovuar nga Kuvendi Komunal me datën 29.05.2008.

Neni 6.

Me bashkësi do të udhëheqë komiteti i bashkësisë i cili përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha fshatrave në kuadër të bashkësisë.

Komitetin e bashkësisë e përbëjnë nga dy përfaqësues nga secili fshat, ndërsa bashkësitë që përbëhen vetëm nga dy fshatra secili fshat do të ketë nga tre përfaqësues në komitetin e bashkësisë.

Kryetari i Komitetit të fshatit është njëkohësisht anëtarë i Komitetit të bashkësisë, ndërsa anëtarët tjerë zgjedhën nga qytetarët e fshatit drejtë për drejtë në votim të fshehtë në listën prej dy apo më shumë anëtarësh.

Komiteti i bashkësisë nga përbërja e vet e zgjedh kryetarin dhe zëvendës kryetarin.

Një anëtarë i Kuvendit Komunal do ta përfaqësoi Kuvendin në Komitetin e bashkësisë si vëzhgues.

Neni 7.

Glllogoci është shpallë qytet me vendimin e Kuvendit Komunal.

Në aspektin organizativ të bashkësisë së Glllogocit funksionon si bashkësia e parë në përbërje me lagjet urbane, i I, II, Lagja e Dëshmorëve dhe Lagja e Feronikelit.

Fshati Shtrubullovi dhe Glllobar.

Ngjashëm është organizua edhe bashkësia e Komoranit ku përveç fshatrave në përbërje të saj të përcaktuara me Statutin e Komunës bënë pjesë edhe lagja urbane Komorani I.

Neni 8.

Zabeli / Lari

KUVENDI KOMUNAL
MUNICIPAL ASSEMBLY
01 Nr. 031-3438
Më 06.06.2008
On GLLOGOC



Në bazë të nenit 5.1 dhe 5.3 të Rregullores nr. 2007/30 mbi ndryshimin e Rregullores 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, neni 34.2 germa (e) të Statutit të Komunës së Glllogocit, Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e vetë të mbajtur me 29.05.2008 aprovoi këtë:

R R E G U L L O R E
MBI ORGANIZIMIN E BASHKËSIVE, FSHATRAVE, VENDBANIMEVE DHE
LAGJEVE URBANE, KOMPETENCAT DHE RREGULLAT E PROCEDURËS
PËR BASHKËPUNIM NË MES TË KOMUNËS DHE FSHATRAVE E
BASHKËSIVE

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1.

Me këtë Rregullore do të përcaktohet:

- Organizimi i bashkësive, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
- Format e bashkëpunimit në mes të komunës, bashkësive, fshatrave dhe lagjeve urbane.
- Vëllimi i punëve që do të ushtrojë bashkësitë dhe fshatrat në kuadër të kompetencave të tyre.
- Ushtrimi i punëve dhe aktiviteteve që janë në përgjegjësinë dhe kompetencat e komunës por që me pëlqimin e komunës dhe në marrëveshje me fshatrat dhe bashkësitë do ti ushtrojnë këto të fundit

Organizimi i bashkësive dhe fshatrave

Neni 2.

Organizimi i bashkësive dhe fshatrave është organizimi apolitik.
Zgjedhja e anëtarëve të Komitetit të bashkësisë dhe fshatit behet drejtë për drejtë nga qytetaret që përfaqësojnë të gjitha interesat e qytetarëve jashtë bazave partiake.

Neni 3.

Bashkësia e fshatrave është bashkësi e dy apo më shumë fshatra përkatësisht vendbanimeve apo lagjeve urbane me qëllim të realizimit dhe përmbushjes së interesave e nevojave të përbashkëta për fshatrat e bashkësisë.

Neni 4.

Fshati është njësia e parë organizative e qytetarëve të një vendbanimi apo dy e më shumë lagjeve dhe vendbanimeve në të cilin qytetarët në mënyrë të drejtë për drejtë i realizojnë interesat e tyre individuale dhe të përbashkët në sferat e caktuara të jetës dhe të punës.

Neni 5.

Territori i Komunës së Glllogocit në aspektin administrativ dhe politik është organizuar në bashkësi sipas nenit 10 të Statutit të Komunës së Glllogocit të aprovuar nga Kuvendi Komunal me datën 29.05.2008.

Neni 6.

Me bashkësi do të udhëheqë komiteti i bashkësisë i cili përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha fshatrave në kuadër të bashkësisë.

Komitetin e bashkësisë e përbëjnë nga dy përfaqësues nga secili fshat, ndërsa bashkësitë që përbëhen vetëm nga dy fshatra secili fshat do të ketë nga tre përfaqësues në komitetin e bashkësisë.

Kryetari i Komitetit të fshatit është njëkohësisht anëtarë i Komitetit të bashkësisë, ndërsa anëtarët tjerë zgjedhën nga qytetarët e fshatit drejtë për drejtë në votim të fshehtë në listën prej dy apo më shumë anëtarësh.

Komiteti i bashkësisë nga përbërja e vet e zgjedh kryetarin dhe zëvendës kryetarin.

Një anëtarë i Kuvendit Komunal do ta përfaqësoi Kuvendin në Komitetin e bashkësisë si vëzhgues.

Neni 7.

Glllogoci është shpallë qytet me vendimin e Kuvendit Komunal.

Në aspektin organizativ të bashkësisë së Glllogocit funksionon si bashkësia e parë në përbërje me lagjet urbane, i I, II, Lagja e Dëshmorëve dhe Lagja e Feronikelit.

Fshati Shtrubullova dhe Glllobar.

Ngjashëm është organizua edhe bashkësia e Komoranit ku përveç fshatrave në përbërje të saj të përcaktuara me Statutin e Komunës bënë pjesë edhe lagja urbane Komorani I.

Neni 8.

Fshatrat e Komunës së Glllogocit janë përcaktuar me nenin 11 të Statutit të Komunës.

Neni 9.

Fshati udhëhiqet nga Komiteti i fshatit.

Komiteti i fshatit përbëhet prej 5 deri në 7 anëtarë.

Anëtarët e Komitetit zgjedhën drejtë për së drejti nga qytetarët e fshatit me votim të fshehtë në përfaqësimin e interesave të gjithë qytetarëve.

Komiteti i fshatit nga përbërja e vet zgjedhë kryesuesin e komitetit i cili do të njihet si Kryetar i fshatit dhe zëvendës kryetari me mandat dy vjeçar me mundësi rizgjedhje.

Gjatë procesit të zgjedhjeve një anëtarë i Kuvendit Komunal merr pjesë si vëzhgues.

Neni 10.

Komiteti i bashkësisë së fshatrave dhe Komiteti i fshatrave punon në mbledhje dhe vendimet i merr me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit.

Të drejtat dhe përgjegjësit e bashkësisë dhe fshatrave

Neni 11.

Bashkësia e fshatrave si bashkësi e qytetarëve të dy apo më shumë fshatrave në të cilën qytetarët e fshatrave të bashkësisë realizojnë interesat e përbashkëta dhe solidarisht i plotësojnë nevojat e veta të përbashkëta për të gjitha çështjet dhe nevojat e përditshme për jetë dhe punë në kuadër të bashkësisë së fshatrave e posaçërisht kujdesen:

- Për rregullimin e vendbanimeve të tyre,
- Mirëmbajtjen e rrugëve lokale në territorin e bashkësisë,
- Për mirëqenien e qytetarëve të fshatrave të bashkësisë.
- Për çështje të arsimit, kulturës, shëndetësisë etj brenda territorit të bashkësisë së tyre,
- Për mbrojtjen e ambientit të njeriut për fshatrat e bashkësisë
- Për ndërtimin dhe rindërtimin e fshatrave në kuadër të bashkësisë e sidomos të objekteve në interes të përbashkët për bashkësi
- Harton listën prioritare të ndërtimit dhe rindërtimit të fshatrave në kuadër të bashkësisë.
- Bashkëpunon me organizatat OJQ dhe donator të ndryshëm.
- Vendos për ndarjen proporcionale të ndihmave humanitare për secilin fshat në përbërje të bashkësisë
- Propozon Kuvendit Komunal ndryshimin e emrit të bashkësisë apo të fshatit

- Bashkëpunon me kuvendin e Komunës dhe organet e administratës komunale për bashkërendimin dhe kryerjen e punëve shoqërore e me interes të përbashkët për bashkësi.
- Harton programet ideore për zhvillimin e infrastrukturës së bashkësisë dhe programet tjera zhvillimore në interes për bashkësinë dhe i propozon ato për metalizim dhe realizim komunës dhe donatorëve të ndryshëm.
- Kujdeset që në nivel të bashkësisë të organizoi mbrojtjen nga fatkeqit elementare dhe eliminimin e pasojave të tyre.
- **Kryen dhe punë tjera me interes të përbashkët për bashkësi**

Neni 12.

Fshati në kuadër të të drejtave dhe përgjegjësi të tijë për realizimin e interesave të përbashkëta të qytetarëve të fshatit dhe plotësimin e nevojave të përditshme e të përbashkëta me interes për jetën dhe punën e qytetarëve të fshatit dhe familjeve të tyre kujdeset

- përkuesin shoqëror ndaj fëmijëve,
- për arsimi, kulturë, shëndetësi dhe banorët e fshatit,
- për mbrojtjen sociale për familjet në gjendje të rëndë ekonomike e sociale,
- për infrastrukturën e fshatit (ndërtimin e objekteve për shfrytëzim të përbashkët si shkollat, rrugët, ujësjellësin, kanalizimin, ndriçimin, fushat sportive dhe rekreative etj)
- evidentimin e dëmeve të luftës në fshatin e tyre dhe ofrimin e këtyre të dhënave, organeve komunale dhe donatorëve të tjerë që ndihmojnë në ndërtim,
- bashkëpunon me organizatat jo qeveritare humanitare dhe ofron shënimet për rastet sociale të familjeve në fshat,
- harton listën prioritare dhe bënë kategorizimin e objekteve banimore për familjet e fshatit të cilat duhet të rindërtohen në bazë të kriterëve të përcaktuar na organet komunale dhe donatorët e jashtëm,
- bënë evidentimin e qytetarëve të vrarë përkatësisht të zhdukur të luftës, numrin e dëshmorëve, familjet e tyre numrin e fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe ofrimin e këtyre shënimeve organeve kompetente komunale.

Neni 13.

Të gjitha punët përkatësisht të drejtat dhe përgjegjësit të përcaktuara me nenin 9 të kësaj Rregullore në emër të bashkësisë së fshatrave i kryen dhe vendos komiteti i bashkësisë i cili udhëheq me bashkësi.

Komiteti i bashkësisë së paku 10 herë në vit mbanë mbledhje me qytetarët e të gjitha fshatrave në kuadër të bashkësisë ku diskutohen çështjet me relevante për bashkësinë dhe merren propozimet direkte të fshatrave për çështjet me interes të përbashkët për fshatrat e bashkësisë.

Neni 14.

Komiteti i fshati në emër të fshatit kryen të gjitha punët në kuadër të të drejtave dhe përgjegjësi të fshatit të përcaktuar me nenin 10 të kësaj Rregullore. Ndërsa drejtë për drejtë Komiteti i fshatit do të vendosë dhe ushtrojë këto punë dhe aktivitete:

- vendos për hartimin e listës së familjeve për rindërtimin e shtëpive të shkatërruara nga lufta,
- bënë caktimin me prioritet të shtëpive të banimit për rindërtim në bazë të kriterëve të caktuara nga organet komunale për kategorizimin e shtëpive të shkatërruara.
- Evidenton të gjitha dëmet materiale të luftës,
- Mbanë evidencën dhe ofron shënimet për numrin e familjeve në fshat, numrin e banorëve të fshatit, strukturën gjinore, gjendjen ekonomike e sociale, numrin e dëshmorëve dhe të rënëve tjerë në luftën për Çlirimin e Kosovës, familjet pa përkujdesje prindore etj.
- Harton listën dhe propozon familjet për asistencë sociale,
- Drejtpërdrejtë bënë ndarjen e ndihmave materiale për familjet që ndihmohen nga OJQ e sidomos administron dhe ndanë ndihmat e shoqatës humanitare Nëna Terezë, Kryqit të Kuq të Kosovës dhe shoqatave tjera humanitare që veprojnë në Kosovë.
- Në bashkëpunim me organet komunale bashkësinë dhe donatorët tjerë bënë shpërndarjen e materialit ndërtimor për familjet e fshatit,
- Merr iniciativë konkrete të organizimit të qytetarëve të fshatit për çështjet me rëndësi për fshatin e sidomos në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve në interes të përbashkët për fshatin duke marrë obligimet përkatëse në përfshirjen e qytetarëve të fshatit për punë të përbashkët grumbullimin e mjeteve të përbashkëta dhe format e tjera të bashkëpunimit për realizimin e projekteve me interes të përbashkët për fshatin, bashkësinë dhe komunën.
- Bënë fletëparaqitjet te organet kompetente komunale për uzurpimet arbitrare të pasurisë shoqërore-shtetërore në rajonin e fshatit apo të bashkësisë,
- Bënë organizimin e jetës në fshat (organizimin e jetës kulturore, sportive etj.)

Neni 15.

Bashkësia e fshatrave dhe fshati qeverisin me objektet dhe pasurit e patundshme që i ndërtojnë qytetarët me punën dhe mjetet e tyre.

Në bashkësi dhe fshatra komuna mund t'i bartë në qeverisje dhe shfrytëzim objektet dhe pasurit tjera të pa ligjshme të cilat qytetarët dhe para miratimit të kësaj Rregullore në punën e vet apo me bashkimin e metëve dhe punës i ka ndërtuar apo kam marrë pjesë në ndërtim.

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të këtyre pasurive përcaktohet me kontratë në mes të fshatit, bashkësisë dhe komunës.

Neni 16.

Interesat dhe nevojat e veta të përbashkëta në bashkësi dhe fshat qytetarët i plotësojnë :

- me mjetet të cilat vetë drejtë për drejtë i bashkojnë me anë të vetë kontributit.
- Me pjesën e mjeteve financiare të caktuara të komunës të cilat ajo i ndanë bashkësisë apo fshatit në pajtim me programet e zhvillimit të bashkësisë apo fshatit.
- Me pjesën e mjeteve nga buxheti dhe fondet e veçanta të komunës.
- Me pjesën e mjeteve të donatorëve të jashtëm apo të brendshëm në pajtim me projektet për zhvillimin e komuniteteve dhe marrëveshjet që lidhin bashkësi apo fshat me donatorët tjerë

Neni 17

Në procedurën e hartimit të planeve detale urbanistike, të programe të zhvillimit të veprimtarive shërbyese, shëndetësore, arsimore, sociale dhe veprimtarive tjera më interes për qytetarët e bashkësisë dhe fshatit Kuvendi i Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe organet tjera kompetente të administratës duhet që paraprakisht të marrin në shqyrtimin propozimet dhe mendimet e bashkësive dhe fshatrave dhe të informojnë ato mbi qëndrimet dhe vendimet e veta.

Neni 18

Me qëllim sigurimi që qytetarët e fshatrave dhe bashkësive të marrin pjesë aktivisht në tërë procesin e përgatitjeve, nxjerrjen e vendimeve dhe miratimin e tyre, për çështjet me interes të përgjithshëm në komunë, mbahen diskutime të gjëra publike, konsultime si dhe mund të organizohet referendumi me karakter lokal për një apo më shumë bashkësi për çështje të caktuara në pajtim me dispozitat e Statutit të Komunës .

Delegimi i kompetencave dhe përgjegjësi të komunës në fshatra dhe Bashkësi.

Neni 19

Me pëlqimin e saj komuna, fshatrave dhe bashkësive, përkatësisht komiteteve që e udhëheqin me to vet apo me grupe mund t'u besoj apo delegoj ushtrimin e disa aktiviteteve dhe punëve të saja e sidomos:

- Organizimi dhe ndërtimi i vendbanimeve, përkatësisht rindërtimi i shtëpive të rrënuara nga lufta;
- Mënjanimi i pasojave dhe dëmtimet e shkaktuar nga lufta;
- Furnizimi i qytetarëve me ujë të pijshëm;
- Mbrojtja e ambientit ;
- Pastrimi i sipërfaqeve publike me vendbanime;
- Mirëmbajtja e varrezave;
- Mirëmbajtja e varrezave;
- Monumentet historike dhe përmendoreve;
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbërta publike;
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale;

- Mbajtja dh rregullimi i transportit lokal;
- Aktivitetet e caktuara kulturore sportive etj.

Neni 20

Të gjitha punët dhe aktivitetet e përcaktuara me nenin 17 të kësaj rregullore fshati dhe bashkësia i realizojnë me punën dhe mjetet e qytetarëve të saj, mjetet e donatorëve të jashtëm si dhe mjetet të cilat komuna është e detyruar t'i siguroj nga buxheti i saj apo nga fondet përkatëse.

Neni 21

Fshatrat dhe bashkësitë janë përgjegjëse për zbatimin e rregulloreve dhe vendimeve të pushtetit lokal, përkatësisht komunës dhe organeve të saj.

Neni 22

Kryetarët e Komiteteve të Bashkësive dhe Komitetet e fshatrave janë përgjegjës për realizimin e drejtpërdrejt të rregulloreve vendimeve dhe akteve tjera të pushtetit lokal që kanë të bëjnë në përgjegjësin e bashkësive dhe fshatrave.

Kryetarët Komiteteve të Bashkësisë dhe Komiteteve të fshatrave për punën e vet do të kompensohen me meditoje për mbledhjen e mbajtur në komunë në shumën prej 25 €

Neni 23

Me qëllim të realizimit më të shpejt dhe efikas të të drejtave dhe obligimeve të tyre, komiteti i bashkësisë dhe komiteti i fshatrave për lëmi të caktuara të jetës dhe të punës mund të caktoj edhe komisione dhe nënkomisione të veçanta siç janë:

- Komisioni për rindërtim,
- Komisioni për ndihma dhe çështje sociale,
- Komisioni për Arsim, Shëndetësi, Kulturë e sport dhe
- Komisioni për bujqësi .

Këto komisione përbëhen nga tre anëtarë të cilët i cakton komiteti i fshatit, kryetari i secilit komision është njëri nga anëtarët e komitetit të fshatit.

Kryetarët e Komisionet të fshatrave përbëjnë komisionet përkatëse të bashkësive.

Të gjitha komisionet dhe nënkomisionet që i formon komiteti i bashkësisë apo i fshatit për komunën e vet i përgjigjen komitetit përkatës i cili i ka caktuar, ndërsa kryetarët e komiteteve të fshatrave dhe bashkësive janë përgjegjës para kuvendit komunal dhe mbi këqyrjen e punës së tyre e bën Zëvendëskryetari i Kuvendit Komunal sipas kompetencave që ka Statutin e Komunës .

Neni 24

Si komision i detyrueshëm që duhet të caktohet nga Komiteti i Bashkësisë dhe Komiteti i Fshatit është Komisioni i Pajtimit. Ky komision përbëhet nga tre anëtarë të caktuar nga

komiteti përkatës nga radha e qytetarëve autoritativë dhe nën ndikim në fshat apo bashkësinë e tyre .

Kryetari i Komitetit të fshatit apo bashkësisë është exoficio Kryetari i Komisionit të pajtimit për fshatin apo bashkësinë.

Komisioni i pajtimit të bashkësisë përbëhet nga kryetarët e komisioneve të pajtimit të fshatrave dhe asaj bashkësie . Komisioni i pajtimit i bashkësisë zgjedh kryetarin dhe nënkryetarin nga përbërja e anëtarëve të këtij komisionin .

Neni 25

Të drejtat dhe përgjegjësit e komisionit të pajtimit janë:

- Evidentimi i konflikteve në mes të qytetarëve të bashkësisë apo fshatit;
- Ndërmjetësimi në zgjidhjen e mos marrëveshjeve dhe konflikteve në mes të qytetarëve në kuadër të fshatit apo bashkësisë ;
- Përcjellja e dukurive konfliktuoze në fshat përkatësisht bashkësi;
- Bashkëpunimi në komitetin e ndërmjetësimit të Kuvendit Komunal si dhe informimi për punën e vet në këtë komitet;
- Zgjidhja përkatësisht përfundimi i të gjitha kontesteve në mes të qytetarëve me kompromis apo me marrëveshje.

Neni 26

Shkarkimin anëtarëve të këtij Komisioni e bën komiteti i fshatit apo bashkësisë, nëse e konstaton :

- Mos efikasiteti në punën e tyre,
- Efektet negative të punës së tyre;
- Për përfundimin e kontesteve me marrëveshje ;
- Nëse anëtari i komisionit dënohet për veprë penale të dënueshme me tre e më shumë vite burg etj.

Neni 27

Kuvendi i Komunës do të siguroj që të gjitha shërbimet komunale të shtrihen në të gjitha bashkësitë dhe fshatrat në mënyrë të drejt të barabar dhe efikase.


Neni 28

Dispozitat përfundimtare

Kjo Rregullore hynë në fuqi pas diskutimit publik në të gjitha fshatrat dhe bashkësitë e Komunës së Glllogocit dhe aprovimi nga ana e Kuvendit Komunal.

Drenas 29.05.2008

Kryesuesi i Kuvendit


Nexhat Demaku

